

**UDHËZIM**  
**Nr. 3, datë 9.1.2017**

**PËR MËNYRËN DHE AFATET PËR KRYERJEN E PAGESËS SË TARIFËS SË  
LICENCIMIT PËR SECILËN KATEGORI TË LOJËRAVE TË FATIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 155/2015, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

**UDHËZON:**

1. Shoqëritë e regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me objekt të ushtrimit të aktivitetit organizimin e lojërave të fatit dhe të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë, sipas kategorisë përkatëse në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, deklarojnë dhe paguajnë tarifën e licencës, sipas përcaktimeve dhe afateve të përcaktuar në këtë udhëzim.

2. Tarifat e licencimit për secilën kategori lojëra fati, llogaritet në këste të barabarta vjetore, përgjatë të gjithë afatit të licencimit.

3. Deklarimi i tarifës së licencimit, kryhet nga subjektet e lojërave të fatit, në përputhje me procedurat dhe modelin e deklaratës së miratuar në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar. Ky deklaram kryhet vetëm në rrugë elektronike, nëpërmjet faqes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

4. Subjektet e lojërave të fatit duhet të dorëzojnë deklaratat e tyre tatimore çdo muaj pavarësisht se detyrimi i tarifës për periudhën tatimore (muajore) është zero dhe subjekti nuk ka për të paguar detyrime muajore për tarifën e licencës.

5. Kësti vjetor i tarifës së licencimit paguhet brenda datës 15 janar të vitit korrent për të cilin paguhet tarifa vjetore. Deklarimi për këstin vjetor të tarifës së licencimit bëhet me deklaratën e periudhës tatimore dhjetor brenda datës 15 janar të çdo viti.

6. Në vitin e parë të aktivitetit të lojërave të fatit, subjektet e licencuara, deklarojnë pagesën e tarifës së licencimit të barabartë me këstin vjetor, në periudhën tatimore në të cilën janë licencuar, e cila deklarohet dhe paguhet e plotë brenda datës 15 të muajit pasardhës.

7. Ngarkohen organizatorët e lojërave të fatit, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe organet tatimore, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Arben Ahmetaj**